



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA DURRËS  
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 95, datë 06.09.2022

PËR

**MIRATIMIN E NJË NDRYSHIMI NË ANEKSIN NR.1, TË VENDIMIT TË KËSHILLIT BASHKIAK NR. 22, DATË 25.02.2021 “PËR MIRATIMIN E LISTËS TË SUBJEKTEVE PËRFITUESE, QË DO TË PËRFITOJNË NGA PROGRAMI I PROÇESIT TË RINDËRTIMIT PËR PALLATIN NR. 1062, RRUGA “26 NËNTORI” DHE PALLATIN NR. 14, RRUGA “PETRAQ BOSHNJAKU”, NJËSIA ADMINISTRATIVE NR. 2, TË DËMTUARA NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019”**

Në zbatim të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të Ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Ligjit nr.45/2019, “Për mbrojtjen civile”, Ligjit nr.44/2015, “Kodi i Proçedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, Aktit Normativ nr.9, datë 16.12.2019, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me Ligjin nr.97/2019, Ligjit nr. 22, datë 03.05.2018 “Për strehimin social”, VKM nr.301 datë 15.04.2020, “Për normat e strehimit”, VKM-së nr. 904, datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe proçedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga disa programe të proçesit të rindërtimit”, VKM-së nr. 5, datë 06.01.2020 “Për përcaktimin e rregullave dhe proçedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model”, i ndryshuar, VKM-së nr.329, datë 16.05.2021 “Për kriteret dhe proçedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, VKM-së nr. 750, datë 27.11.2019 “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës dhe Tiranë”, Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 22, datë 25.02.2021 “Për miratimin e listës të subjekteve përfituese, që do të përfitojnë nga programi i proçesit të rindërtimit për pallatin nr. 1062, rruga “26 Nëntori” dhe pallatin nr. 14, rruga “Petraq Boshnjaku”, njësia administrative nr.2,

të dëmtuara nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019”, kërkesës nr. 6084 prot., datë 08.07.2022 të z.Myftar Jançari, shkresës së kryetares së Bashkisë Durrës me nr. 6084/2 prot, datë 01.09.2022, Rregullores së Funkcionimit të Këshillit Bashkiak Durrës si edhe sipas relacionit të 2 komisioneve të përhershëm të këshillit, me propozim të Komisionit të Rregullores, Çështjeve Ligjore dhe Komisionit të Strehimit dhe Shërbimeve Publike,


**KËSHILLI BASHKIAK**  
**V E N D O S I :**

1. Miratimin e një ndryshimi në Aneksin nr.1 “Pallati nr. 1062, Rruga “26 Nëntori”, të Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 22, datë 25.02.2021 “Për miratimin e listës të subjekteve përfituese, që do të përfitojnë nga programi i proçesit të rindërtimit për Pallatin nr. 1062, Rruga “26 Nëntori” dhe Pallatin nr. 14, Rruga “Petraq Boshnjaku”, Njësia Administrative nr.2, të dëmtuar nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019”.
2. Miratimin e ndryshimit në Aneksin nr.1, pjesë përbërëse e Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.22, datë 25.02.2021, përsa i përket përfituesit z. Myftar Jançari në masën e strukturës së njësisë së banimit 2+1, sipas relacionit hartuar nga Komisioni i Rregullores, Çështjeve Ligjore si dhe Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, Komisioni i Posaçëm për Vlerësimin dhe për Zgjedhjen e Përfituesve nga Programet e Proçesit të Rindërtimit dhe Zyra e Posaçme e Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike pranë Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Bashkia Durrës.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

**ZËVENDËSKRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK**

**Zamira Mustafaraj**



**U shpall sot me datë 07.09.2022**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 700 / prot.  
5

Durrës, më 13 .09 .2022

**Lënda:** Verifikim i ligjshmërisë së aktit

**KËSHILLIT BASHKIAK  
DURRËS**

**KRYETARIT TË BASHKISË  
DURRËS**



Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.95 datë 06.09.2022

Për miratimin e një ndryshimi në aneksin nr 1, të VKB Nr 22 dt 25.02.2021 „ Për miratimin e listës së subjekteve përfituese, që do të përfitojnë nga programi i procesit të rindërtimit për pallatin nr 1062, Rruga „26 Nëntori“ dhe pallatin nr 14 Rr.Petraq Boshnjaku“, Njësia Administrative nr 2, të dëmtuara nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26.11.2019.

Ky vendim në bazë të Ligjit nr 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative” neni 3 pika 2 nuk është akt me karakter normativ. Vendimi është akt administrativ individual bazuar në nenin 3 pika 1/a të Ligjit nr 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, pasi i drejtohet një subjekti të përcaktuar individualisht duke krijuar një marrëdhënie juridike konkrete si dhe është i shteruar në zbatimin e tij.

Në bazë të Ligjit Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” (neni 8/a) “Prefekti i qarkut verifikon ligjshmërinë e vendimeve, urdhrave dhe urdhëresave me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore”

Për sa më sipër verifikimi i këtij vendimi duke qenë një akt administrativ me karakter individual **nuk është në kompetencën e Prefektit të Qarkut.**

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

**PREFEKTI  
EMILJAN JANI**

